

ZËRI I POPULLIT RRETH

**'FINALES
SË MADHE'**

NDËRMJET

KOSOVËS DHE SERBISË

VËLLIMI I





Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10
Prishtinë 10000
Republic of Kosovo
T/F: +381 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
W: www.ridea-ks.org

***Zëri i Popullit* rreth ‘FINALES SË
MADHE’ ndërmjet Kosovës dhe
Serbisë**

Vëllimi I

Shkurt 2019

***Zëri i Popullit* rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë Vëllimi I**

Ky sondazh u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Shkurt 2019

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhja Ekzekutive.....	i
1. Hyrja.....	1
2. Metodologjia	2
2.1. Dizajni i Sondazhit	2
2.2. Procedura e Sondazhit	3
2.3. Mostra	3
2.4. Karakteristikat e Mostrës	5
2.5. Analiza e të dhënave	9
3. Gjetjet: Rruga përpara ose prapa	9
3.1. Ndërpreja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.....	9
3.2. Vijat e kuqe të Kosovës në lidhje me fazën përfundimtare të dialogut	11
3.3.A duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?.....	17
3.4. <i>Tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë</i>	19
3.4.1. Skenari i parë: Vazhdimi i status kuo-së.....	19
3.4.2. Skenari i dytë: Njohja de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/Bashkësinë e komunave serbe të Kosovës.....	21
3.4.3. Skenari i tretë: Njohja de facto dhe de jure e shtetësisë së Kosovës nga Serbia në këmbim të korigjimit të kufijve/aranzhimeve të reja territoriale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	25
4. Përfundimet	28

Përmbledhja Ekzekutive

Qëllimi i këtij sondazhi është identifikimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët rreth 'finaleve të madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Numri i 1110 të anketuarve në këtë sondazh (90% shqiptarë, 9% serbë dhe 1% nga grupet e tjera etnike) e përbëjnë mostrën përfaqësuese të popullsisë së Kosovës. Të dhënat nëpërmjet anketimit për këtë sondazh janë mbledhur mes 17 dhe 26 dhjetorit 2018. Puna në terren u administrua fillimisht në një pilot grup, me qëllim që të bëhen korrigjimet përfundimtare të pyetësorit.

Në këtë studim, në secilën komunë është përdorur *mostra e thjeshtë proporcionale*, duke u bazuar në numrin e popullsisë së komunës. Pyetësi përbëhet nga pyetje të hapura dhe të mbyllura. Në mënyrë që të kontrollohet puna e intervistuesve gjatë mbledhjes së të dhënave, rreth 15% (gjithsej 150 të anketuar) u ri-intervistuan. Kjo kontrollë është bërë përmes intervistave telefonike dhe vizitave në terren. Për të kryer procesin e verifikimit, të anketuarit u pyetën rreth 5 pyetjeve bazuar në intervistën orgjinale. Lista e kontrollit shërbeu si një mjet i rishikimit të parimeve të rastësishme të lokalitetit, pikës fillestare, njësisë së shtëpisë dhe parimin e zgjedhjes së respondentit. Përgjigjet e intervistës së parë dhe të dytë u krahasuan. Përveç procesit të zakonshëm të shqyrtimit, u krye një kontroll logjik i pyetësorëve të plotësuar. Matja prej 95% të *kufirit (marginës) së gabimit* bazuar në mostrën e plotë është përafërsisht +/-3 pikë përqindjeje. Sidoqoftë, intervalet e besimit për vlerësimet e bazuara në nëngrupet e mostrës, siç është mostra serbe prej 100 të anketuarve, do të jenë dukshëm më të mëdha.

Sa i përket rezultateve, në paragrafët e mëposhtëm paraqesim gjetjet për çështjet vijuese:

- i) ndërpreja ose mosndërpreja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;

- ii) vijat e kuqe të Kosovës në lidhje me fazën finale të dialogut;
- iii) në rast të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, a duhet Kosova të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë; dhe
- iv) perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me **tre skenarët** për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Grupi i parë i gjetjeve tregon se shumica e popullsisë së Kosovës është kundër ndërprerjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në përgjithësi, **62%** e të gjithë të anketuarve nuk pajtohen me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si shqiptarët dhe serbët në Kosovë pajtohen që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë. Ekziston mbështetje më e ulët mes serbëve për vazhdimin e dialogut dhe një numër i rëndësishëm nga mostra serbe nuk kanë pasur opinion në këtë pyetje (27%). **63%** në mesin e shqiptarëve dhe **54%** në mesin e serbëve 'nuk pajtohen' ose 'disi nuk pajtohen' me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Grupi i dytë i gjetjeve fokusohet në vijat e kuqe të Kosovës në lidhje me fazën përfundimtare të dialogut. Rezultatet janë:

- Liqeni i Ujmanit duhet të mbetet brenda territorit të Kosovës (96% të shqiptarëve kundrejt 5% të mostrës serbe);
- Trepça duhet të mbetet pjesë e Kosovës (99% të shqiptarëve kundrejt 9% të mostrës serbe)
- Lugina e Preshevës duhet t'i bashkohet Kosovës (69% shqiptarëve kundrejt 0% të mostrës serbe);
- Lugina e Preshevës duhet të mbetet pjesë e Serbisë (13% të shqiptarëve kundrejt 84% të mostrës serbe); dhe
- Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviçit) **nuk** duhet t'i bashkohet Serbisë (91% të shqiptarëve kundrejt 10% të mostrës serbe).

Grupi i tretë i gjetjeve fokusohet në çështjen nëse Kosova duhet të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë (në rast të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë). Në këtë kontekst, opinioni është i ndarë, në përgjithësi, **43%** përkrahin idenë se *Kosova duhet të kërkojë bashkimin me Shqipërinë* në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia dhe **50%** e refuzon këtë ide. Megjithatë, **49%** në mesin e shqiptarëve dhe **76%** e serbëve nuk pajtohen me opsionin që Kosova duhet të kërkojë bashkimin me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia.

Grupi i katërt dhe i fundit i gjetjeve paraqet perceptimin dhe preferencat e qytetarëve të Kosovës lidhur me **tre skenarët alternativ** për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kështuqë, në lidhje me **skënarin e parë - status kuo-** vetëm një numër i vogël i të anketuarve (rreth **15%**) u përgjigjën me '*shumë të kënaqur*' ose '*disi të kënaqur*' rreth status kuo-së aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Analiza e veçantë e mostrave shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ndryshëm të përgjigjeve. Në këtë kuptim, **82%** në mesin e shqiptarëve krahasuar me **50%** në mesin e serbëve janë ose '*aspak të kënaqur*' ose '*shumë pak të kënaqur*' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Sa i përket **skënarit të dytë - dhënies së kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia-** ka edhe më pak mbështetje sesa për skënarin e parë. Vetëm 10% e të anketuarve janë përgjigjur me '*fuqimisht pajtohem*' ose '*disi pajtohem*' me skënarin e dytë. Përsëri, ka mbështetje të dobët në mesin e shqiptarëve të Kosovës (**9%**) dhe serbëve (**16%**) për t'i dhënë kompetenca ekzekutive asociacionit/bashkësisë së komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia.

Sa i përket **skënarit të tretë - 'njohjes de facto dhe de jure të shtetësisë së Kosovës nga Serbia, e cila do të përfshinte korrigjimin e kufijve/ aranzhime të reja territoriale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë'**, u gjeneruan të dhënat në vijim: Ekziston një masë disi e ngjashme por shumë e vogël përkrahjeje (12% e shqiptarëve dhe 5% e serbëve) për skënarin-variantin e korrigjimit territorial në

këmbim të njohjes de facto dhe de jure të Kosovës nga Serbia. Sidoqoftë, krahasuar me skenarët-variantet tjera, ka më shumë përkrahje në mesin e popullsisë shqiptare **(30%)** dhe përkrahje afërsisht të njëjtë në mesin e serbëve **(27%)** për korrigjimin e kufijve që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB.

Sa i përket *tre skenarëve*, një analizë e shkurtër krahasuese mbi interpretimin e rezultateve gjeneron pasqyrën e mëposhtme: ka pak mbështetje nga të anketuarit (16% janë përgjigjur me 'shumë të kënaqur' ose 'disi të kënaqur') për vazhdimin e status kuo-së **(skenari 1)** dhe madje edhe më pak (10% u përgjigjën me 'fuqimisht pajtohem' ose 'disi pajtohem') për dhënien e kompetencave ekzekutive për asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, me kusht të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia **(skenari 2)**. Sidoqoftë, ka më shumë përkrahje (30% e të anketuarve janë përgjigjur me 'definitivisht duhet' ose 'duhet') lidhur me korrigjimin e kufijve që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB **(skenari 3)**.

Një vlerësim krahasues ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në lidhje me *tre skenarët* prodhon gjetjet pasuese: Një numër i vogël i të anketuarve shqiptarë (14%) dhe më shumë serbë (27%) shprehën kënaqshmërinë e tyre për status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë **(skenari 1)**. Në mënyrë të ngjashme, 9% në mesin e shqiptarëve dhe 16% në mesin e serbëve shprehën pajtimin e tyre për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia **(skenari 2)**. Në kontrast me dy skenarët e mëparshëm, 30% në mesin e shqiptarëve, por ngjashëm me skenarin e parë, 27% në mesin e serbëve mbështesin korrigjimin e kufijve që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB **(skenari 3)**.

Në përgjithësi, mund të konkludohet se opinioni publik është jo-konsistent dhe me pozicione kontradiktore. Përderisa, fjalët e përdorura në pyetje mund të

ndikojnë në përqindjet e sakta që favorizojnë ose kundërshtojnë opsione të veçanta, mund të konkludohet se popullsia serbe dhe shqiptare e Kosovës flasin me zëra të ndryshëm në lidhje me vijat e tyre të kuqe dhe skenarët e preferuar, por me një zë mbi nevojën për të vazhduar dialogun.

E fundit, por jo për nga rëndësia, mund të vërehet se nuk ka përkrahje substanciale nga komuniteti shumicë në Kosovë (shqiptarët) për ndonjë nga tre skenarët. Kjo flet për faktin se për të qenë e pranueshme ndonjë marrëveshje e 'finales së madhe' nga shumica e (*vox populi - zërit të popullit*) në Kosovë, ajo duhet të sjellë diçka të qëndrueshme, thelbësore dhe funksionale në Kosovë, përndryshe është e destinuar të dështojë.

1. Hyrja

Të dhënat për këtë studim u mblodhën në datat 17-26 dhjetor 2018. Qëllimi i këtij sondazhi ishte të kuptoheshin perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët e 'finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka hyrë në fazën përfundimtare dhe një numër skenaresh eventuale janë përshkruar në studime dhe debate të ndryshme. Prandaj, një objektiv tjetër i studimit ishte të kuptohej mbështetja publike, ose ndoshta mungesa e mbështetjes, për skenarë të ndryshëm për marrëveshjen eventuale përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në fakt, marrëveshja e prillit 2013 për përfshirjen e veriut të Kosovës në kornizën ligjore të Prishtinës, por në anën tjetër shtimin e të drejtave për komunitat e dominuara nga serbët në Kosovë, mbetet ende një nga marrëveshjet politikisht më kontroverze dhe jo të zbatuara nga të dy vendet¹.

Megjithatë, përkundër sukseseve dhe dështimeve në zbatimin e marrëveshjeve, normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet ndër prioritetet kryesore në agjendën e Bashkimit Evropian, me të gjitha palët që tashmë kanë konfirmuar angazhimin e tyre për të intensifikuar veprimet e tyre për normalizim të plotë të marrëdhënieve dhe perspektivës konkrete për aspiratat e tyre drejt BE-së². Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç tashmë kanë theksuar gatishmërinë e tyre për të intensifikuar punën në mënyrë që të arrihet një marrëveshje ligjërishme e detyrueshme. Në këtë drejtim, të dy vendet kanë bërë përgatitjet dhe kanë themeluar ekipet për fazën përfundimtare të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

¹ Komisioni European (2013) 'Serbia dhe Kosova*:marrëveshja historike hap rrugën për përparim vendimtar në perspektivat e tyre të BE-së", Komunikatë për shtyp, 22 prill. E disponueshme: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-347_en.htm (Qasur më: 30/01/2019).

² EUEA (2018) 'Federica Mogherini priti një takim të Dialogut të Nivelit të Lartë me Presidentin Thaçi të Kosovës dhe Presidentin Vuçiç 'Komunikatë për shtyp, 8 nëntor.E disponueshme:https://eeas.europa.eu/diplomatic-network/eu-facilitated-dialogue-belgrade-pristina_relations/53466/federica-mogherini-hosted-meeting-high-level-dialogue-president-tha%C3%A7i-kosovo-and-president_en (Qasur më: 30/01/2019).

Një skenar i mundshëm që tashmë po diskutohet publikisht si në Kosovë ashtu edhe në Serbi është shkëmbimi i territoreve, me të cilën Kosova do të fitonte disa pjesë nga Lugina e Preshevës në këmbim të territorit në veri të Kosovës dhe njohjen e Kosovës nga Serbia³. Duke patur parasysh këtë skenar dhe skenarët e tjerë të identifikuar në hulumtimet e mëparshme në Kosovë⁴; ky raport hulumtues ka për qëllim të identifikojë nivelin e mbështetjes publike nga qytetarët e Kosovës për skenarët potencial mbi marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse që do të ishte ligjërish e detyrueshme për Kosovën dhe Serbinë.

Përtej çështjeve të tjera të diskutuara në seksionet e mëposhtme, ky raport hulumtues ofron një analizë të hollësishme të gjetjeve mbi skenarët kryesorë të mundshëm për një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Raporti fokusohet në tre skenarë kryesorë të mundshëm: a) vazhdimin e *status quo-së*; b) njohjen de facto nga Serbia, në këmbim të kompetencave ekzekutive të zgjeruara për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës; dhe c) njohjen de facto dhe de jure të shtetësisë së Kosovës nga Serbia, e cila do të përfshinte korrigjimin e kufijve/aranzhimet e reja territoriale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përderisa këto janë skenarët kryesorë të ekzaminuar në këtë raport, do të diskutohen edhe një varg variantesh dhe alternativash të mundshme.

2. Metodologjia

2.1. Dizajni i Sondazhit

Pyetësi i këtij sondazhi përbëhet nga pyetjet e hapura dhe të mbyllura me strukturën e vijuese: të dhënat demografike për pjesëmarrësit, perceptimin, qëndrimin dhe mbështetjen, ose mungesën e mbështetjes për skenarët/opsionet

³ ECFR (2018) 'Çmimi i normalizimit: Serbia, Kosova dhe një marrëveshje e rrezikshme kufitare', *Komentari*, 13 nëntor. E disponueshme:

https://www.ecfr.eu/article/commentary_the_price_of_normalisation_serbia_kosovo_and_a_risk_y_border_deal (Qasur më: 30/01/2019).

⁴RIDEA & BPRG (2017) ' Skenaret për ' Finalen e Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë'. E disponueshme: [http://ridea-](http://ridea-ks.org/uploads/SCENARIOS%20FOR%20THE%20GRAND%20FINALE%20BETWEEN%20KOSO)

[ks.org/uploads/SCENARIOS%20FOR%20THE%20GRAND%20FINALE%20BETWEEN%20KOSOVO%20AND%20SERBIA.pdf](http://ridea-ks.org/uploads/SCENARIOS%20FOR%20THE%20GRAND%20FINALE%20BETWEEN%20KOSOVO%20AND%20SERBIA.pdf) (Qasur më: 30/01/2019).

potenciale për Marrëveshjen Përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Fillimisht, pyetësi u administrua në një pilot grup prej 30 të anketuarve për të bërë testimin e kuptueshmërisë nga të anketuarit dhe korrigjimet përfundimtare në pyetësor.

2.2. Procedura e Sondazhit

Ekipi hulumtues përbëhej nga 15 intervistues në terren (2 për secilin prej 7 rajoneve të Kosovës, plus një intervistues special për të anketuarit serbë në jug të Kosovës) dhe 4 hulumtues, eksperti kryesor dhe 2 ekspertë të lartë dhe një hulumtues i ri. Puna e tyre rezultoi në raportin aktual të hulumtimit. Intervistuesit në terren i administruan pyetësorët me letër dhe stilolaps. Pyetësi u plotësua nga intervistuesit në terren për të siguruar që nuk kishte mungesë të të dhënave. Megjithatë, të anketuarit ishin të lirë të mos i përgjigjeshin pyetjeve. Për të shmangur paragjykimin e intervistimit, ekipi hulumtues i trajnoi të gjithë intervistuesit në terren në zbatimin e sondazhit.


Për të kontrolluar punën e intervistuesve gjatë mbledhjes së të dhënave, rreth 15% (gjithsej 150 të anketuar) u ri-intervistuan. Ky kontroll është bërë përmes intervistave telefonike dhe vizitave në terren. Si kontroll, të anketuarit u pyetën rreth 5 pyetjeve bazuar në intervistën origjinale. Lista e kontrollit shërbeu si një mjet për rishikimin e pajtueshmërisë me parimin e përzgjedhjes së rastësishme të të anketuarve (që mbulojnë përzgjedhjen e lokalitetit, pikën fillestare, njësinë e shtëpisë dhe zgjedhjen e të anketuarit). Përgjigjet e intervistës së parë dhe të dytë u krahasuan. Përveç procesit të zakonshëm të kontrollit, u krye një kontroll logjik i pyetësorëve të plotësuar.

2.3. Mostra

Sondazhi u krye në 38 komuna të Kosovës të 7 rajoneve kryesore në Kosovë: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë (Veri dhe Jug, shih hartën më poshtë). Kosova ka një popullsi prej 1.798.506 banorë⁵. Në këtë

⁵Ajencia e Statistikave të Kosovës(2018) 'Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018'. E disponueshme:<http://ask.rks-gov.net/media/4369/statistical-yearbook-2018.pdf> (Qasur më: 30.01.2019).

sondazh, është përdorur mostra e thjeshtë proporcionale bazuar në numrin e popullsisë për secilën komunë. Llogaritja e përqindjes së pjesëmarrjes përbëhet nga raporti ndërmjet numrit të popullsisë së regjistruar në një komunë të caktuar dhe numrit total të banorëve të regjistruar në Kosovë. Përqindja që rezulton përcakton peshën e secilës komunë në mostër. Baza e popullsisë së regjistruar është nxjerrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.



Pyetësorët u administruan në shtëpitë dhe banesat e të anketuarve. Për të përcaktuar mostrën e studimit është përdorur procedura e mostrës së rastësishme, me rregullat e përcaktuara për zgjedhjen e pikës fillestare, dhe përzgjedhjen pasuese të rrugës, ndërtesës, apartamentit dhe respondentit. Pyetësori u administrua tek vetëm një anëtar i familjes. Ky kurs i veprimit është


zbatuar, në mënyrë që të shmangen njëanshmëria/paragjykimet e të intervistuarve në mostër.

Për të pasur një mostër mjaftueshëm të madhe të serbëve për analiza të përdorshme, mostra është dyfishuar në dy komunat kryesore serbe, Mitrovicës Veriore (në veri të Kosovës) dhe Graçanicë (në jug të Kosovës). Kjo shpiti në një mostër prej 100 të anketuarve serbë, në vend të 50 të anketuarve që do duhej të ishin po të mos dyfishonim numrin e mostrës.

2.4. Karakteristikat e Mostrës

Numri i përgjithshëm i të anketuarve për këtë sondazh është 1110. Me një mostër të kësaj madhësie, kufiri i gabimit në vlerësim është plus ose minus 3 pikë përqindjeje (në nivelin të signifkancës 5 për qind). Vini re që, gabimi i mostrimit mund të jetë shumë më i madh kur vlerësimet janë vetëm për mostrën serbe prej 100 të anketuarve: me një mostër prej 100, intervali i konfidencës prej 95% do të jetë përafërsisht plus ose minus 10 pikë përqindjeje. Të gjitha dallimet ndërmjet mostrave serbe dhe shqiptare janë kontrolluar për signifkancë statistikore.

Siç është thënë më lart, studimi është kryer në të gjitha (shtatë) rajonet e Kosovës dhe (tridhjetë e tetë) komunat. Shih mëposhtë shpërndarjen e mostrës në shtatë rajonet.



Numri i intervistave për secilën komunë është caktuar në bazë të numrit të popullsisë në çdo komunë dhe shpërndarja e mostrës së arritur kështu korrespondon ngushtë me shpërndarjen e popullsisë. Shihni mëposhtë tabelën që përshkruan numrin e popullsisë bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës⁶ dhe numrin e intervistave të realizuara nëpër komuna.

Tabela 1. Madhësia e popullësisë dhe numri i intervistave për komunë


Nr	Komuna	Popullsia	Nr.i të intervistuarve
1	<i>Ferizaj</i>	<i>103,003</i>	<i>63</i>
2	<i>Shtime</i>	<i>27,654</i>	<i>35</i>
3	<i>Kaçanik</i>	<i>33,409</i>	<i>20</i>
4	<i>Shtërpcë</i>	<i>6,773</i>	<i>8</i>
5	<i>Hani i Elezit</i>	<i>9,998</i>	<i>6</i>
6	<i>Gjakovë</i>	<i>95,340</i>	<i>58</i>
7	<i>Rahovec</i>	<i>59,102</i>	<i>36</i>
8	<i>Deçan</i>	<i>41,808</i>	<i>27</i>
9	<i>Junik</i>	<i>6,370</i>	<i>4</i>
10	<i>Gjilan</i>	<i>80,162</i>	<i>48</i>
11	<i>Kamenica</i>	<i>30,750</i>	<i>19</i>
12	<i>Viti</i>	<i>47,615</i>	<i>29</i>
13	<i>Ranillug</i>	<i>3,810</i>	<i>3</i>
14	<i>Novobërdë</i>	<i>7,160</i>	<i>5</i>
15	<i>Partesh</i>	<i>1730</i>	<i>2</i>

⁶Po aty.

16	<i>Kllokot</i>	2,753	2
17	<i>Mitrovicë</i>	69,346	42
18	<i>Vushtrri</i>	64,468	39
19	<i>Mitrovica Veriore</i>	12,211	40
20	<i>Zveçan</i>	7,376	5
21	<i>Zubin Potok</i>	6,616	5
22	<i>Leposaviq</i>	13,587	10
23	<i>Skenderaj</i>	52,343	32
24	<i>Pejë</i>	99,568	61
25	<i>Istog</i>	40,380	11
26	<i>Klinë</i>	40,122	12
27	<i>Prishtinë</i>	211,755	131
28	<i>Obiliq</i>	19,144	12
29	<i>Fushë Kosovë</i>	38,607	24
30	<i>Lipjan</i>	57,733	35
31	<i>Podujevë</i>	83,445	51
32	<i>Glllogoc</i>	61,133	19
33	<i>Graçanicë</i>	12,091	20
34	<i>Prizren</i>	191,565	114
35	<i>Suharekë</i>	60,247	21
36	<i>Malishevë</i>	58,269	36
37	<i>Mamushë</i>	5,950	4
38	<i>Dragash</i>	34,316	21
Totali		1,798,506	1110

90% e mostrës së studimit ishin shqiptarë, 9% serbë dhe 1% ishin nga grupet tjera etnike në Kosovë. Përqindja shqiptare e mostrës korrespondon ngushtë me regjistrimin e vitit 2011, gjë që tregon se 91% janë shqiptarë, 3.4% serbë dhe 5.6% 'të tjerë'. Meqenëse përqindja për shqiptarët në mostër është afër shifrës së regjistrimit, ne nuk i kemi ponderuar të dhënat për përkatësinë etnike. (Numri i vogël i grupeve etnike 'të tjera' është shumë i vogël për analiza të dobishme dhe nuk ofron një bazë të besueshme për ponderim.)

58% e mostrës janë meshkuj dhe 42% femra. Moshë mesatare e mostrës është 38 vjeç dhe moshë ka një shtrirje prej 18-84 vjeç. Mëposhtë është shpërndarja e mostrës sipas grupmoshës.



Krahasuar me shifrat e regjistrimit për vitin 2011, meshkujt dhe të rinjtë janë të mbi-përfaqësuar në mostrën e arritur. Prandaj, ne kemi kontrolluar të gjitha rezultatet duke përshtatur ponderimin me këtë, si mosha sipas ndarjes gjinore të publikuar në regjistrimin e popullsisë në Kosovë 2011. Në praktikë kjo matje kishte vetëm një efekt të vogël mbi vlerësimet, pasi që as mosha, as gjinia nuk janë të lidhura fuqishëm me shpërndarjen e variablave në të cilat ky raport fokusohet. Për këtë arsye ne thjesht kemi raportuar përqindjet e ponderuara.

Sa i përket nivelit të arsimit, 1% e mostrës ka raportuar se nuk kanë diplomë shkollore, 3% kanë raportuar vetëm arsim fillor (1-5 klasë), 9% kanë raportuar arsim të mesëm të ulët (6-9 klasë), 40% shkollë të mesme të lartë (gjimnaz ose shkollë profesionale), 5% arsim profesional pas shkollës së mesme, 35% kanë deklaruar se kanë diplomë universitare (Bachelor), 7% kryesisht me Master, dhe pak me doktoraturë. Siç është e zakonshme me sondazhet, ekziston një mbi-përfaqësim i atyre me arsim të lartë.

Sa i përket nivelit të punësimit të mostrës sonë, 45% janë raportuar të jenë punësuar në kohën e intervistës, 34% të papunë, 9% studentë, 7% në pension, 4% që përmbushin detyrat të caktuara dhe 1% të papërcaktuar.

2.5. Analiza e të dhënave

Përgjigjet e pjesëmarrësve u futën në SPSS. Statistikat përshkruese, të tilla si frekuencat dhe kros-tabulimet në bazë të grupeve etnike, janë përdorur për të analizuar të dhënat. Ne gjithashtu kemi kontrolluar nëse rezultatet ndryshojnë sipas moshës, gjinisë, nivelit arsimor dhe gjendjes së punësimit. Pyetjet e hapura në SPSS u analizuan ndaras.


3. Gjetjet: Rruga përpara ose prapa

Kjo pjesë përshkruan gjetjet e këtij sondazhi në katër nën-seksione: **(i)** ndërprerja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; **(ii)** vijat e kuqe të Kosovës në lidhje me fazën përfundimtare të dialogut; **(iii)** në rast të një marrëveshjeje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, a duhet Kosova të mbetet si shtet më vete apo të bashkohet me Shqipërinë; dhe **(iv)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me *tre skenarët* për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.


3.1. Ndërpreja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Në lidhje me këtë çështje është parashtruar pyetja në vijim: **A pajtoheni me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?**

Gjetjet në lidhje me këtë çështje prodhuan peisazhin vijues: 29% e mostrës totale shprehën se 'fuqimisht pajtoheshin' ose 'disi pajtoheshin' për ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërtën, shumica e pjesëmarrësve (62%) 'nuk pajtohen' ose 'disi nuk pajtohen' për ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërtën, rreth 10% e pjesëmarrësve u deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Vlerësimi i përgjigjeve për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ngjashëm të përgjigjeve (edhe pse dallimet midis dy grupeve janë statistikiisht domethënëse): 30% në mesin e shqiptarëve dhe 19% në mesin e serbëve shprehen se 'fuqimisht pajtohen' ose 'disi pajtohen' rreth ndërprerjes të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 63% në mesin e shqiptarëve dhe 54% në mesin e serbëve 'fuqimisht nuk pajtohen' ose 'disi nuk pajtohen' për ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 8% në mesin e shqiptarëve dhe 27% në mesin e serbëve deklarohen se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



3.2. Vijat e kuqe të Kosovës në lidhje me fazën përfundimtare të dialogut

Sa i përket vijave të kuqe, ne i pyetëm respondentët:

Çfarë mendoni se duhet të jenë vijat e kuqe të Kosovës në fazën e re të dialogut?

Të gjithë pjesëmarrësit janë njoftuar mbi konceptin e vijave të kuqe: intervistuesit shpjeguan "Me vija të kuqe unë nënkuptoj kushtet që qeveria duhet t'i mbaj me çdo çmim dhe të mos jetë e gatshme të bëjë kompromis". Bazuar në debatet publike dhe publikimet e mëparshme, katër çështje u përzgjedhën si "vija të kuqe" potenciale, përkatësisht juridiksioni mbi liqenin e Ujmanit, miniera e Trepçës, nëse Lugina e Preshevës duhet të bashkohet me Kosovën dhe nëse disa pjesë të veriut të Kosovës duhet të bashkohen me Serbinë.

Liqeni i Ujmanit


Liqeni i Ujmanit është aseti kryesor i projektit të ujësjellësit shumë-dimensional Ibër-Lepenci zhvilluar nga institucionet krahinore të Kosovës në Jugosllavi në fund të viteve 1960 si pjesë e një master plani për të zhvilluar lumenjtë kryesorë në Kosovë, domethënë Ibrin dhe Lepencin, në mënyrë që të sigurohet ujë për industrinë, komunitetet, ujitjen dhe prodhimin e energjisë. Liqeni i Ujmanit ka një sipërfaqe prej 11.9 km² prej të cilave 9.2 km² shtrihen në territorin e Kosovës dhe 2.7 km² në territorin e Serbisë. Liqeni i Ujmanit akumulohet nga lumi Ibër, një nga lumenjtë kryesorë në Kosovë që së bashku me degët e tij përbën një nga pesë pellgjet ujore kryesore të Kosovës - dhe që mbulon një sipërfaqe prej 4044.21 km². Rezervuari i tij është rreth 24 km i gjatë dhe 12 km i gjerë dhe përfaqëson rezervën më të madhe të ujit në vend. Kjo e bën atë një pasuri strategjike me rëndësi të madhe për Kosovën jo vetëm në aspektin e sigurisë së ujit, por edhe në zhvillimin ekonomik (bujqësinë dhe industrinë) dhe sigurinë njerëzore.



Foto e Liqenit të Ujmanit⁷

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, 88%, u përgjigjën se '*Liqeni i Ujmanit duhet të mbetet brenda territorit të Kosovës*' (shih grafikun më poshtë). Analiza e mostrave shqiptare dhe serbe tregon një ndryshim të rëndësishëm në përgjigjet. 96% në mesin e shqiptarëve dhe 5% në mesin e serbëve u përgjigjën me "Liqeni Ujmanit duhet të mbetet brenda territorit të Kosovës". 0.6% në mesin e shqiptarëve dhe 60% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Liqeni i Ujmanit nuk duhet të mbetet brenda territorit të Kosovës. 3% në mesin e shqiptarëve dhe 35% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Nuk kam ide se cilën rrugë duhet ndjekur'. Analiza të mëtejshme tregojnë se shumica e serbëve (69%) nga rajoni i Mitrovicës u përcaktuan për alternativën 'Nuk kam ide se cila rrugë duhet ndjekur'.

⁷ Tripadvisor (2012) 'Foto e Mitrovicës, Liqeni i Ujmanit' A.M. E disponueshme: <https://www.tripadvisor.com/LocationPhotoDirectLink-g774868-i47688133-Mitrovica.html> (Qasur më: 30/01/2019).



Trepça


Miniera e Trepçës në Stantërg i takon qytetit të Mitrovicës. Mitrovica është padyshim një nga qytetet më të rëndësishme jo vetëm në Kosovë por edhe në të gjithë Gadishullin e Ballkanit dhe më gjerë, për burimet minerare⁸. Në fakt, Trepça eksportoi mallra me vlerë prej 103 milionë dollarë në vitin 1983, duke u renditur si eksportuesi i pestë (5) më i lartë në ish-Jugosllavi⁹. Për 58 vjet të prodhimit, Trepça prodhoi 33 milionë ton minerale. Në parim, rezervat e mineraleve dhe minierave në Trepçë përbëjnë bazën e kontestit mbi Trepçën. Gjetjet tona në lidhje me këtë ndërmarrje janë paraqitur mëposhtë.

Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve 91% u përgjigjën me "*Trepça duhet të mbetet pjesë e Kosovës*" (shih grafikun më poshtë). Analiza e mostrave shqiptare dhe serbe përsëri zbulon një ndryshim domethënës në përgjigje. 99% në mesin e shqiptarëve dhe 9% në mesin e serbëve u përgjigjën me '*Trepça duhet të mbetet pjesë e Kosovës*'. 0.6% në mesin e shqiptarëve dhe 50% në mesin e serbëve u përgjigjën me '*Trepça nuk duhet të mbetet pjesë e Kosovës*'. 0.4% në mesin e shqiptarëve dhe 41% në mesin e serbëve u përgjigjën me '*Nuk kam ide se cilën rrugë duhet ndjekur*'. Analiza të mëtejshme tregojnë se shumica e

⁸ Trepça 'Ndërmarrje në Administrim të AKP' E disponueshme: <http://www.trepca-akp.com/pages/posts/2/> (Qasur më: 30/01/2019).

⁹Po aty.

serbëve (83%) nga rajoni i Mitrovicës vendosin për alternativën 'Nuk kam ide se cila rrugë duhet ndjekur'.




Lugina e Preshevës duhet të bashkohet me Kosovën


Megjithëse pjesë e Serbisë, Lugina e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, që shtrihet në një sipërfaqe prej përafërsisht 1249 km²) është e lidhur në mënyrë thelbësore me Kosovën. Shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës theksojnë se ata kanë shumë më pak të drejta vetëqeverisëse sesa që Kosova ua jep serbëve; qysh para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, udhëheqësit e Luginës së Preshevës kanë miratuar një rezolutë duke deklaruar se do të pranojnë të qëndrojnë në Serbi, por "në rast të një ndryshimi eventual të kufijve të Kosovës, Lugina do të punojë drejt bashkimit me Kosovën"¹⁰. Gjetjet më poshtë përfaqësojnë qëndrimet e qytetarëve të Kosovës, lidhur me të ardhmen e Luginës së Preshevës.

¹⁰Marko Prelec (2013) 'Ankesat në Preshevë dhe bisedimet Kosovë-Serbi' Grupi i Krizës, 1 shkurt. E disponueshme: <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/presevo-s-grievances-and-kosovo-serbia-talks>(Qasur më: 30/01/2019).

Shumica e të anketuarve (62%) u përgjigjën se 'Lugina e Preshevës duhet të bashkohet me Kosovën' (shih grafikun më poshtë). Analiza e mostrave shqiptare dhe serbe tregon një ndryshim thelbësor midis përgjigjeve të tyre. 69% në mesin e shqiptarëve dhe 0% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Lugina e Preshevës duhet të bashkohet me Kosovën' ndërsa 13% në mesin e shqiptarëve dhe 81% në mesin e serbëve u përgjigjën me opsionin se 'Lugina e Preshevës **nuk** duhet t'i bashkohet Kosovës'. 18% në mesin e shqiptarëve dhe 19% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Nuk kam ide se cilën rrugë duhet ndjekur'.




Kur pyetja u bë në mënyrë të kundërt, domethënë **nëse Lugina e Preshevës duhet të mbetet pjesë e Serbisë**, rezultatet ishin në thelb të njëjta. Shumica e pjesëmarrësve (65%) u përgjigjën se "Lugina e Preshevës nuk duhet të mbetet pjesë e Serbisë" (shih tabelën më poshtë). Analiza e mostrave të shqiptarëve dhe serbëve tregon një ndryshim të rëndësishëm në përgjigjet e tyre. 13% në mesin e shqiptarëve dhe 84% në mesin e serbëve u përgjigjën me "Lugina e Preshevës duhet të mbetet pjesë e Serbisë" në krahasim me 72% në mesin e shqiptarëve dhe 16% në mesin e serbëve që u përgjigjën me opsionin "Lugina e Preshevës nuk duhet të mbetet pjesë e Serbisë". 16% në mesin e shqiptarëve dhe 0% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Nuk kam ide se cilën rrugë duhet ndjekur'.



Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviçi) duhet t'i bashkohen Serbisë

Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviqit) përfshin një sipërfaqe prej afërsisht 1000 km² të banuar me një shumicë nga serbët etnikë. Paragrafi i mëposhtëm paraqet mendimet e qytetarëve të Kosovës për të ardhmen e këtij territori.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (84%) u përgjigjën se 'Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviçi) nuk duhet të bashkohen me Serbinë' (shih grafikun më poshtë). Analiza e mostrave shqiptare dhe serbe përsëri zbulon një ndryshim të rëndësishëm në përgjigjet e tyre. 4% në mesin e shqiptarëve dhe 41% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviçi) duhet të bashkohen me Serbinë' ndërsa 91% në mesin e shqiptarëve dhe 10% në mesin e serbëve u përgjigjën me opsionin 'Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviçi) nuk duhet të bashkohen me Serbinë'. 5% në mesin e shqiptarëve dhe 49% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'Nuk kam ndonjë ide se cilën rrugë duhet ndjekur'.




3.3. A duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?

Në pyetjen nëse Serbia e njeh Kosovën, a duhet të kërkohet bashkimi me Shqipërinë, nëpërmjet sondazhit u ngrit pyetja në vijim:


A duhet që Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia?

Në lidhje me këtë pyetje (në rast të njohjes de facto dhe de jure të Kosovës nga Serbia, a duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?), gjetjet ishin si më poshtë:

Pothuajse 43% e mostrës totale u përgjigj me Kosova 'duhet patjetër' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkimin me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia. Gjysma e mostrës (50%) u përgjigjën se Kosova 'definitivisht nuk duhet' ose 'ndoshta nuk duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia. 8% në mesin e pjesëmarrësve u deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Vlerësimi i përgjigjeve të mostrave shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ndryshëm të përgjigjeve: 44% në mesin e shqiptarëve dhe 6% në mesin e serbëve janë përgjigjur me Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia. 49% në mesin e shqiptarëve dhe 75% në mesin e serbëve (një ndryshim statistikisht domethënës) u përgjigjën se Kosova 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të kërkojë bashkimin me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia. 7% në mesin e shqiptarëve dhe 18.8% në mesin e serbëve u deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' në lidhje me këtë çështje.



3.4. Tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Pjesëmarrësit e sondazhit u njoftuan me opsionet/alternativat vijuese për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: a) vazhdimin e status kuo-së; b) njohje de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës; dhe c) njohje de facto dhe de jure të shtetësisë së Kosovës nga Serbia në këmbim të korigjimit të kufijve/arranzhimeve të reja territoriale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për sqarim, intervistuesit u shpjeguan të anketuarve, se çfarë nënkuptohet me status kuo¹¹, de-facto dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive¹², dhe de-jure¹³.

3.4.1. Skenari i parë: Vazhdimi i status kuo-së


Sa i përket skenarit të parë, kemi parashtruar pyetjen e mëposhtme: Sa jeni të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë? 15% u përgjigjën me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' rreth status kuo-së aktuale

¹¹Me status kuo, nënkuptohet mungesa e njohjes reciproke dhe marrëdhëniet politike dhe diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë të pezulluara.


¹²Me njohjen de facto, nënkuptohet që Serbia i njeh institucionet e Kosovës por nuk do ta njohë shtetësinë e Kosovës; me kompetenca të zgjeruara ekzekutive, nënkuptohen fuqitë që do të përfshijnë ndryshimet kushtetuese në Kosovë dhe do të krijojnë entitet të ri politik në Kosovë, që do të ishte një njësi gjysmë autonome.

¹³Me njohjen de jure, nënkuptohet që Serbia do të njohë kufijtë e Kosovës dhe shtetësinë e saj.

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shih grafikun më poshtë). Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (79%) u përgjigjën me 'shumë pak' ose 'aspak i kënaqur' për status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 6% u përgjigjën me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Analiza e veçantë e mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ndryshëm të përgjigjeve. 14% në mesin e mostrës shqiptare dhe 29% në mesin e serbëve u shprehen 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 82% në mesin e shqiptarëve në krahasim me 50% në mesin e serbëve janë 'shumë pak të kënaqur' ose 'aspak të kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 4% në mesin e shqiptarëve dhe 21% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Këto dallime janë statistikisht domethënëse (në nivelin 0.05), por rezultatet janë në përputhje me idenë se në të dy komunitetet ka një disponim për ndryshim.




3.4.2. Skenari i dytë: Njohja de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/Bashkësinë e komunave serbe të Kosovës


Lidhur me këtë skenar, pjesëmarrësve i'u parashtruan pyetjet e mëposhtme:

(a) A pajtoheni me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia?

Një numër i vogël i pjesëmarrësve (10%) u deklaruan se 'fuqimisht pajtohem' ose 'disi pajtohem' për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/ bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. Shumica e pjesëmarrësve (84%) pohuan se 'disi nuk pajtohen' ose 'aspak nuk pajtohen' për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia.




Analiza e përgjigjeve të mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ngjashëm të përgjigjeve. 9% në mesin e shqiptarëve në krahasim me 16% në mesin e serbëve ose 'fuqimisht pajtohen' ose 'disi pajtohen' për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, me kusht që Serbia ta njohë de facto Kosovën. 87% në mesin e shqiptarëve në krahasim me 59% të serbëve ose 'disi nuk pajtohen' ose 'nuk pajtohen' për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia (edhe pse dallimi është megjithatë statistikiisht domethënës). 4% në mesin e shqiptarëve dhe 25% në mesin e serbëve u deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Një pikëpamje disi e ndryshme megjithatë u arrit kur pyetja ngriti mundësinë e këmbimit të drejtave për shqiptarët në Luginë të Preshevës me kompetencat ekzekutive për AKS-në. Pyetja që u shtrua në këtë kontekst ishte:


(b) A duhet Kosova të kërkojë më shumë të drejta për shqiptarët në Luginën e Preshevës në këmbim të autonomisë së zgjeruar (kompetenca ekzekutive për Bashkësinë Serbe të Kosovës) për serbët në Kosovë?

Opinionimi ishte më i ndarë në këtë pyetje sesa ka qenë kur dy çështjet janë pyetur veçmas. 38% mendojnë që Kosova ose 'definitivisht duhet' ose 'duhet' të kërkojë më shumë të drejta për shqiptarët në Luginën e Preshevës në këmbim të autonomisë së zgjeruar (kompetencave të zgjeruara për Asociacionin e serbëve të Kosovës) për serbët në Kosovë. Ndryshe, 53% e të anketuarve kanë deklaruar që Kosova 'nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të kërkojë më shumë të drejta për shqiptarët në Luginën e Preshevës në këmbim të autonomisë së zgjeruar (kompetenca ekzekutive për Asociacionin e serbëve të Kosovës) për serbët në Kosovë.



Analiza e përgjigjeve në mostrën shqiptare dhe serbe tregon ndryshime relativisht domethënëse në përgjigjet e tyre. 41% në mesin e shqiptarëve në krahasim me 5% në mesin e serbëve e shohin Kosovën që 'definitivisht duhet' ose 'duhet' të kërkojë më shumë të drejta për shqiptarët në Luginën e Preshevës në këmbim të autonomisë së zgjeruar (kompetencave ekzekutive për Asociacionin e serbëve të Kosovës) për serbët në Kosovë.

Në anën tjetër, 51% në mesin shqiptarëve në krahasim me 72% të serbëve mendojnë se Kosova 'nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të kërkojë më shumë të drejta për shqiptarët në Luginën e Preshevës në këmbim të autonomisë së zgjeruar (kompetenca ekzekutive për Asociacionin e serbëve të Kosovës) për serbët në Kosovë. 8% në mesin e shqiptarëve dhe 23% në mesin e serbëve deklarohen me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




3.4.3. Skenari i tretë: Njohja de facto dhe de jure e shtetësisë së Kosovës nga Serbia në këmbim të korigjimit të kufijve/aranzhimeve të reja territoriale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë


Sa i përket këtij skenari, të anketuarve u janë bërë pyetjet e mëposhtme:

(a) A pajtoheni me korigjimin e kufijve në këmbim të njohjes de facto dhe de jure të Kosovës nga Serbia?

Një numër i vogël i pjesëmarrësve (12%) u shprehën 'fuqishimisht pajtohem' ose 'disi pajtohem' rreth korigjimit të kufirit në këmbim të njohjes de facto dhe de jure të Kosovës. Në të kundërtën, shumica e pjesëmarrësve (82%) u deklaruan me 'disi nuk pajtohem' ose 'fuqimisht nuk pajtohem' me korigjimin e kufirit, në këmbim të njohjes de facto dhe de jure të Kosovës nga Serbia (shih grafikunin më poshtë). 6% u deklaruan me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Ka një model disi të ngjashëm të përgjigjeve (shih grafikonin mëposhtë) në mesin e respondentëve shqiptarë dhe serbë. Bie fjala, 12% në mesin e shqiptarëve dhe 5% në mesin e serbëve shprehen se 'fuqimisht pajtohen' ose 'disi pajtohen' rreth këtij opsioni për korrigjimin e kufirit. 84% në mesin e shqiptarëve dhe 71% në mesin e serbëve u përgjigjën 'disi nuk pajtohem' ose 'fuqimisht nuk pajtohem' me korrigjim të kufijve në këmbim të njohjes de facto dhe de jure të Kosovës nga Serbia. 4% në mesin e shqiptarëve dhe 24% në mesin e serbëve u shprehën me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Pyetja tjetër lidhur me korrigjimin e kufirit ishte:


(b) Nëse korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultojë në njohjen globale të Kosovës dhe hapje të rrugës për anëtarësim në OKB, a duhet Kosova të mbështesë një marrëveshje të tillë për korrigjim të kufijve?

Në anën tjetër, kur pjesëmarrësit u pyetën nëse Kosova duhet të pranojë korrigjim të kufirit nëse do të rezultojë në njohjen globale për Kosovën dhe hapje të rrugës për anëtarësim në OKB, përgjigjet ishin më të ndryshme. Në këtë aspekt, 30% e mostrës u përgjigjën se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të mbështesë opsionin e korrigjimit të kufirit që do të rezultojë në njohjen globale të Kosovës dhe hapje të rrugës për anëtarësim në OKB (shih grafikonin më poshtë). Përndryshe, 60% u përgjigjën me Kosova, 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të mbështesë opsionin e korrigjimit të kufijve që do të rezultojë në njohjen globale të Kosovës dhe hapje të rrugës për anëtarësim në OKB. 10% u deklaruan me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Analiza e veçantë e mostrës shqiptare dhe serbe (siç shfaqet në grafikonin e mëposhtëm) shpërfaqë një model disi të ngjashëm të përgjigjeve. **30% e shqiptarëve dhe 27% e serbëve u përgjigjën se Kosova 'definitivisht duhet'**

ose 'ndoshta duhet' të mbështesë opsionin e korigjimit të kufijve nëse ajo rezulton në njohjen globale të Kosovës dhe hap rrugën për anëtarësim në OKB. 61% në mesin e shqiptarëve dhe 47% në mesin e serbëve u përgjigjën se Kosova 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të mbështesë opsionin e korigjimit të kufijve nëse ajo rezulton në njohjen globale të Kosovës dhe hap rrugën për anëtarësim në OKB. 8% në mesin e shqiptarëve dhe 26% në mesin e serbëve u shprehën me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



4. Përfundimet

Qëllimi i këtij sondazhi ishte të kuptohen perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët rreth 'finalës së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në kuadër të këtij sondazhi janë anketuar 1110 respondentë (90% shqiptarë, 9% serbë dhe 1 % nga grupet e tjera etnike) dhe kjo e përbën mostrën përfaqësuese të popullsisë së Kosovës.

Gjetjet e sondazhit tregojnë se shumica e popullësisë së Kosovës është *kundër ndërprerjes të dialogut* ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në përgjithësi, 62% e të gjithë të anketuarve nuk pajtohen me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të dy palët, shqiptarët dhe serbët e Kosovës pajtohen që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë. 63% në mesin e shqiptarëve dhe 54% në mesin e serbëve u shprehën me 'fuqimisht nuk pajtohem,' ose 'disi

nuk pajtohem' me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i mostrës serbe nuk kishte mendim për këtë çështje (27%).

Megjithëse shumica e popullsisë së Kosovës është kundër ndërprerjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sondazhi tregon megjithatë se shqiptarët dhe serbët kanë shumë pak pajtim për rrugën përpara lidhur me marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ka dallime ekstreme (të gjitha statistikisht domethënëse) për vijat e kuqe në fazën e ardhshme të dialogut:

- Liqeni i Ujmanit duhet të mbetet brenda territorit të Kosovës (96% e shqiptarëve kundrejt 5% të mostrës serbe);
- Trepça duhet të mbetet pjesë e Kosovës (99% e shqiptarëve kundrejt 9% të mostrës serbe);
- Lugina e Preshevës duhet t'i bashkohet Kosovës (69% e shqiptarëve kundrejt 0% të mostrës serbe);
- Lugina e Preshevës duhet të mbetet pjesë e Serbisë (13% e shqiptarëve kundrejt 84% të mostrës serbe);
- Veriu i Kosovës (Zveçani, pjesë të Zubin Potokut dhe Leposaviçit) nuk duhet t'i bashkohen Serbisë (91% e shqiptarëve kundrejt 10% të mostrës serbe). Duhet të theksohet se 49% e mostrës serbe zgjedhën 'Nuk e di se cilën rrugë duhet ndjekur' rreth kësaj çështjeje.

Sondazhi shpërfaqë se opinioni është i ndarë në lidhje me *bashkimin e Kosovës me Shqipërinë* në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia. Përgjithësisht, 43% përkrahin idenë që Kosova duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë në rast të njohjes de facto dhe de jure nga Serbia. Megjithatë, 49% në mesin e shqiptarëve dhe 75% në mesin e serbëve nuk pajtohen me opsionin që Kosova duhet të kërkojë bashkimin me Shqipërinë.

Sa i përket *tre skenarëve*, ka pak mbështetje në mesin e të anketuarve (16% janë përgjigjur me 'shumë të kënaqur' ose 'disi të kënaqur') për vazhdimin e status quo-së (**skenari 1**) dhe madje edhe më pak (10% e të anketuarve janë

dëklaruar me 'fuqimisht pajtohem' ose 'disi pajtohem') për dhënien e kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia **(skenari 2)**. Sidoqoftë, ka më shumë përkrahje (30% e të anketuarve janë përgjigjur me 'definitivisht duhet' ose 'duhet') lidhur me korrigjimin e kufirit që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB **(skenari 3)**.

Dallimet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve sa i përket *tre skenarëve* ishin shumë më të vogla sesa ato për *vijat e kuqe*. Vetëm një numër i vogël i të anketuarve shqiptarë (14%) dhe serbëve (27%) shprehën kënaqësinë e tyre me status kuonë aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë **(skenari 1)**. Në mënyrë të ngjashme, vetëm 9% në mesin e shqiptarëve dhe 16% në mesin e serbëve shprehën pajtimin e tyre me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/ bashkësinë e komunave serbe të Kosovës në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia **(skenari 2)**. Për dallim nga dy skenarët e mëparshëm, 30% në mesin e shqiptarëve dhe 27% në mesin e serbëve mbështesin korrigjimin e kufijve që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB **(skenari 3)**.

Në përgjithësi, opinioni publik në Kosovë është i pakënaqur me status kuonë, dhe dëshiron që dialogu të vazhdojë, por shqiptarët dhe serbët në Kosovë kanë *vija të kuqe* fuqishëm kundërthënëse dhe mospajtime për shumë çështje të ndërlidhura me fazën përfundimtare të dialogut. Sa i përket *tre skenarëve*, ka disa ndarje ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, por duket se ka mbështetje të ngjashme, edhe pse më pak se shumica, lidhur me *skenarin e tretë*.

Përderisa fjalët dhe shprehjet e përdorura në pyetje mund të ndikojnë në përqindjet e sakta që favorizojnë apo kundërshtojnë opsione të veçanta, mund të konkludojmë se popullsia shqiptare dhe serbe e Kosovës flasin me zëra të ndryshëm, veçanërisht në lidhje me linjat/vijat e tyre të kuqe, por me një zë mbi nevojën për të vazhduar dialogun. Përfundimisht, mund të konkludohet se nuk ka mbështetje substanciale në mesin e komunitetit shumicë të Kosovës

(shqiptarët) për ndonjë nga tre skenarët. Kjo flet për faktin se për të qenë e pranueshme ndonjë marrëveshje e 'finale së madhe' nga shumica e *zërit të popullit* në Kosovë, ajo duhet të sjellë diçka të qëndrueshme, thelbësore dhe funksionale në Kosovë, përndryshe është e destinuar të dështojë.

